VENDIM
Nr. 27, datë 2.4.2010

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALPIQ ENERGY ALBANIA" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a" 9 dhe nenit 13 pika 1 germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa "g", neneve 5, 13 dhe 14 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.4.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Alpiq Energy Albania" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë "Alpiq Energy Albania" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9 pika 4.9 germat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë "Alpiq Energy Albania" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta